



Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin

maj - gusht 2017



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Институт за демократија
Социетас цивилис - Скопје

Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin

(maj - gusht 2017)

Ky publikim është përgatitur me ndihmë të Agjencisë Zvicerane për përkrahje dhe zhvillim.
Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas civilis” – Shkup
(IDSCS) dhe në kurrfarë mënyrë nuk mund të llogaritet se i reflekton pikëpamjet e Agjencisë
Zvicerane për përkrahje dhe zhvillim



Instituti për demokraci “Societas civilis” – Shkup (IDSCS), prej qershorit të vitit 2014, e përcjell cilësinë e debatit në Kuvendin dhe raportimin mediatik për punën e Kuvendit. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua gjatë 10 muajve, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015. Prej shtatorit të vitit 2015 monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së debatit parlamentar vazhdon, i përkrahur nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe do të zgjas deri më dhjetor të vitit 2017. Monitorimi në këtë periudhë fokusohet në diskutimet që kanë të bëjnë me pikat e rendit të ditës të cilat i takojnë fushave të sundimit të të drejtës, të drejtat e njeriut dhe të demokracisë. Në atë drejtim, monitorohet ato trupa punuese të kuvendit dhe seancat plenare në fushë-veprimin e të cilave hyjnë fushat e përmendura. Në mënyrë shtesë, në kuadër të projektit janë të përfshira edhe mediet, përkatësisht, monitorohet se si ato raportojnë për punën e Kuvendit. Gjatë monitorimit gjetjet për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin e medieve, publikohen në formë të raporteve tremujore.

Para Jush është raporti për cilësinë e debatit në Kuvendin, që ka të bëjë me periudhën prej 1 maji deri më 31 gusht të vitit 2017.

I. Gjetje kyçe

- Sipas përkatësisë politike të folësve nga monitorimi në këtë periudhë, rezulton se deputetët nga opozita, e cila është e përbërë nga VMRO-DPMNE, Lëvizja BESA dhe PDSH, ishin më aktiv me 80% të diskutimeve, ndërsa deputetët e shumicës të përbërë nga deputetët e LSDM, BDI dhe Aleanca për Shqiptarët kanë marrë pjesë në 20% të diskutimeve të monitoruara.
- Deputetë më aktiv të cilët në foltoren e kuvendit kanë qëndruar më gjatë janë Dimitar Stevanaxhija me 236 minuta, Dragan Danev me 233 minuta dhe Ilija Dimovski me 221 minuta.
- **Në 35% të diskutimeve të analizuara deputetët nuk kishin argumente.** Më tepër se gjysma e diskutimeve karakterizohen me argumentim të dobët (55%) përkatësisht diskutuesit kanë ofruar arsyetim të dobët të pozitive të veta që nuk mjafton të llogaritet për një argument të plotë.
- **60% e diskutimit të deputetëve nga pushteti është dobët i argumentuar.** Në të njëjtën linjë më tepër se gjysma e diskutimeve të deputetëve nga opozita gjithashtu karakterizohet me argumentim të dobët (54%).
- **Në raport me atë se si deputetët ju përgjigjen argumenteve të drejtuara nga diskutuesit e tjerë rezulton se ata më shpesh (61%) pjesërisht u bëjnë vështrim, i shtrembërojnë ose injorojnë argumentet.** Në 10% të rasteve argumentet e folësve të tjerë ishin tërësisht të injoruar, ndërsa në 3% tërësisht të shtrembëruara.
- Analizuar sipas përkatësisë politike të folësve, rezulton se deputetët nga opozita në 65% të diskutimeve të tyre pjesërisht i kanë bërë vështrim, pjesërisht i kanë shtrembëruara ose i kanë injoruar argumentet e tjetrit, ndërsa deputetët nga pushteti atë e kanë bërë në 46% të diskutimeve të monitoruara. Deputetët nga opozita në 11% të diskutimeve i kanë injoruar argumentet e drejtuara nga folësit e tjerë, ndërsa deputetët nga pushteti atë e kanë bërë në 4% të diskutimeve të tyre.
- **Sërisht, njëlloj si edhe në periudhat e deritanishme të monitorimit të cilësisë së debatit parlamentar, te deputetët mbetet mos-ndryshimi konstant i qëndrimeve dhe të pozitive për shkak të argumenteve më të mira të diskutuesve.**
- Deputetët nga opozita në 53% të diskutimeve të tyre nuk kanë ndryshim të qëndrimeve, janë në të njëjtin pozicion, dhe e njohin vlerën e argumenteve, ndërsa **në 18% të diskutimit të tyre nuk kishte ndryshim të qëndrimit dhe nuk pranohen argumentet.** Karakteristike në këtë periudhë është ajo se 46% nga diskutimi i pushtetit karakterizohet me atë që nuk kishte ndryshim të qëndrimit dhe nuk i pranojnë argumentet. Gjithashtu 39% të diskutimeve të pushtetit karakterizohet me atë që nuk kanë referencë ndaj vlerave të argumenteve të të tjerëve.
- Në vetëm 1% të diskutimit të tyre edhe pushteti edhe opozita pa marrë parasysh që nuk e kanë ndryshuar qëndrimin dhe kanë pozitë të ndryshme, njohën vlera të argumenteve të tjetrit.
- **Deputetët më shpesh vendosin t'u bëjnë vështrim kolegëve të tyre se sa argumenteve të drejtuara.**
- Në 36% të diskutimeve ata kanë shprehur respekt të pjesshëm për argumentet, ndërsa respektim të pjesshëm ndaj personalitetit të deputetëve u shpreh në madje 70% të diskutimeve. Kjo do të thotë se deputetët në pjesë të madhe të diskutimeve nuk rezistuan që në diskutimet e tyre të bëjnë shprehje tallëse ose më të buta fyese dhe sulme ndaj personalitetit të kolegëve të tyre nga opsionet e kundërta politike.
- **Respektim për personalitetin është i shprehur në vetëm 2% të rasteve, ndërsa ndaj argumenteve në vetëm 1% të rasteve.**

- Analizuar për nga përkatësia politike e folësve, deputetët e opozitës në 68% të fjalimeve të tyre aspak nuk kishin referencë **ndaj argumenteve** të deputetëve nga pushteti, ndërsa në 31% të diskutimeve ata kanë pasur respektim të pjesshëm.
- Deputetët nga pushteti nuk kanë pasur referencë në 43% të diskutimit të tyre dhe në 54% të diskutimit të tyre kanë pasur respektim të pjesshëm **ndaj argumenteve** të opozitës. Deputetët nga pushteti gjithashtu në 1% të fjalimeve të tyre kanë përdorur fjalor abuziv.
- **Të dy opsionet në vetëm 1% të diskutimit të tyre kanë shfaqur respekt ndaj argumenteve të tjetrit.**
- **Në raport me personalitetin** e deputetëve të tjerë, në 73% të fjalimeve të opozitës është shprehur respektim i pjesshëm, në 2% mos-respektim i pjesshëm, ndërsa në 1% mos-respektim.
- Deputetët e pushtetit në 58% të diskutimeve të tyre kishin respektim të pjesshëm, në 5% mos-respektim të pjesshëm dhe në 3% mos-respektim të plotë.
- **Me rëndësi është të theksohet ajo se në vetëm 3% të fjalimeve të tyre, deputetët nga pushteti dhe 1% të deputetëve nga opozita kanë shfaqur respekt për personalitetin e kolegëve të tyre nga një parti tjetër politike.**
- **Për dallim nga periudhat e mëparshme të monitorimit, në këtë periudhë është rritur pjesëmarrja e grave në punën e Kuvendit. Deputeteve ju takojnë 40% të diskutimeve të vëzhguara.**

II. Konteksti politik

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe për momentin është i përbërë nga 120 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura më 11 dhjetor të vitit 2016, Partia Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (OBRM – PDUKM) dhe koalicioni fitoi 51 deputet, Koalicioni Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM) fitoi 49 deputetë, Ndërsa Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), fitoi 10 deputetë. Lëvizja Besa fitoi 5 deputetë, Aleanca për Shqiptarët fitoi 3 deputetë, ndërsa Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) fitoi 2 deputetë. Mbledhja konstituive zgjati më tepër se një muaj, kishte 21 vazhime dhe kulminoi më 27 prill të vitit 2017¹ me incidentin e përgjakshëm në Kuvend. Kjo seancë përfundoi më 31 maj të vitit 2017. Seanca e parë e rregullt plenare e Kuvendit të Republikës pas ngjarjeve të 27 prillit u mbajt më 30 maj të vitit 2017 me pikë të rendit të ditës – Zgjedhje e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Struktura e Kuvendit në këtë periudhë të monitoruar është ndryshuar. Si pushtet dhe shumicë në diskutimin paraqitet Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë dhe koalicioni, Bashkimi Demokratik për integrim dhe Aleanca e shqiptarëve, ndërsa opozitën e përbëjnë OBRM-PDUKM dhe koalicioni, Lëvizja BESA dhe PDSH. Kjo periudhë karakterizohet me punë jo të rregullt të Kuvendit, obstrukcion gjatë punës së Kuvendit nga opozita dhe vëmendje të madhe të opinionit ndaj punës së deputetëve dhe të drejtën e tyre për pushim në muajin Gusht si dhe me përgaditjet për zgjedhjet lokale të cilat u mbajtën më 15 tetor.

¹ Kuvendi nën thjerrëz: Si diskutuan deputetët në “seancën më të gjatë konstitutive” (gusht, 2017), <http://idsocs.org.mk/wp-content/uploads/2017/08/al.pdf>


III. Gjetje nga monitorimi

Lloji i diskutimeve

Kjo periudhë (maj – gusht 2017) u monitoruan tetë mbledhje plenare dhe katërbëdhjetë debate të komisioneve,² ndërsa gjithsej janë monitoruar 1814 diskutime. Më të diskutuara janë temat ishin Propozimi për shkarkimin e Prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë, Propozim – Ligji për përdorimin e gjuhëve, Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017.

Sipas përkatësisë politike të folësve nga monitorimi i kësaj periudhe rezulton se deputetët e opozitës, e cila është e përbërë nga OBRM-PDUKM, Lëvizja BESA dhe PDSH, ishin më aktiv me 80% të diskutimeve, ndërsa deputetët e shumicës së përbërë nga LSDM, BDI dhe Aleanca për shqiptarët morën pjesë në 20% të diskutimeve të monitoruara.


Grafiku 1



Deputetë më aktiv që në foltoren kuvendore kanë qëndruar më gjatë janë Dimitar Stevanaxhija me 236 minuta, Dragan Danev me 233 minuta dhe Ilija Dimovski me 221 minuta. Sipas asaj se sa herë janë paraqitur për fjalë, më aktive është deputetja Vlladanka Aviroviq e cila fjalën e ka marrë 75 herë, deputeti Vladimir Gjorçev me 69 herë dhe Liljana Zaturavska me 65 herë. Të dhjetë deputetët më aktiv në foltoren kuvendore janë nga OBRM-PDUKM-ja opozitare.


Grafiku 2

²Komisioni ligj-dhënës juridik, Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive, Komisioni për punë dhe politikë sociale, Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave, Komisioni për financim dhe buxhet, Komisioni për çështje evropiane, Komisioni për politikë të jashtme, Komisioni për mbrojtje dhe siguri, Komisioni për arsim, shkencë dhe sport, Komisioni për transport, lidhje dhe ekologji.




Sipas llojit të diskutimeve në këtë periudhë pjesën më të madhe të diskutimeve e përbëjnë replikat (41%) dhe kundër-replikat (40%), ndërsa vetëm 19% nga diskutimet e monitoruara shkojnë në diskutimet.

Grafiku 3



Duke i bërë vështrim llojit të diskutimit sipas përkatësisë politike të diskutuesve, mund të vërehet se pjesa më e madhe e kundër-replikave (84%) dhe replikave (80%) janë të opozitës. Opozitës i takojnë edhe 69% të diskutimeve, duke e pasur parasysh se opozita e përbën pjesën më të madhe të diskutimit (80%).³


Grafiku 4



Shkalla e argumentimit

Në 35% nga diskutimet e analizuara deputetët nuk patën argumente. Më tepër se gjysma e diskutimeve u karakterizuan me argumentim të dobët (55%) përkatësisht diskutuesit kanë ofruar arsyetim të dobët të pozitave të veta gjë e cila nuk mjafton të llogaritet si një argument i plotë. Në vetëm 9% të diskutimeve deputetët përdorën një argument për ta arsyetuar pozitën e tyre. Për këtë periudhë lë përshtypje fakti se midis diskutimeve të monitoruara të deputetëve nuk janë identifikuar të tilla në të cilat diskutuesit kanë përdorur më tepër se dy argumente për ta mbështetur pozitën e vet.


Grafiku 5



³Grafiku nr. 1


Nëse analizohet sipas përkatësisë politike të folësve, vërehet ajo se i tërë diskutimi karakterizohet me argumentim të dobët. 60% i diskutimit i bërë nga deputetët e pushtetit është me argumentim të dobët. Në të njëjtën linjë edhe më shumë se gjysma e diskutimeve të deputetëve nga opozita gjithashtu karakterizohet me argumentim të dobët (54%). Deputetët nga pushteti në vetëm 16% të diskutimit kanë përdorur një argument, ndërsa deputetët nga opozita në vetëm 7%. Deputetët nga opozita gjithashtu në 38% të diskutimeve të tyre nuk kanë përdorur argumente, ndërsa deputetët nga pushteti nuk kanë përdorur argumente në 22% të diskutimeve të tyre.

Grafiku 6




Në raport me atë se si deputetët u përgjigjen diskutuesve të tjerë rezulton se ata më shpesh (61%) pjesërisht u bëjnë vështrim, i shtrembërojnë ose injorojnë argumentet. Në 10% të rasteve argumentet e folësve të tjerë u injoruan tërësisht, ndërsa në 3% janë tërësisht të shtrembëruara. Gjithashtu për shkak të argumentimit të ulët të diskutimit në 23% nuk kishte argumente ose pyetje të drejtuara nga diskutuesit e tjerë. Në vetëm 3% të diskutimeve argumentet ishin të adresuara në mënyrë përkatëse, përkatësisht diskutuesi është përgjigjur në mënyrë të drejtpërdrejtë në argumentet që paraprakisht ja ka drejtuar pjesëmarrës tjetër në seancën.

Grafiku 7



Analizuar sipas përkatësisë politike të folësve, rezulton se deputetët nga opozita në 65% të diskutimeve të tyre pjesërisht u kanë bërë vështrim, pjesërisht i kanë shtrembëruar ose injoruar argumentet e tjetrit, ndërsa deputetët nga pushteti këtë e kanë bërë në 46% të diskutimeve të monitoruara. Deputetët nga opozita në 11% të diskutimeve i injoruan argumentet e drejtuara nga folësit e tjerë, ndërsa deputetët nga pushteti atë e kanë bërë në 4% të diskutimeve të tyre. Në vetëm 2% të diskutimeve të tyre deputetët nga opozita i adresuan argumentet e diskutuesve të tjerë në mënyrë përkatëse, ndërsa deputetët e pushtetit atë e kanë bërë në 6% të rasteve. Në 36% të diskutimit të pushtetit dhe 20% në diskutimet e opozitës nuk ishin drejtuar argumente ose pyetje nga diskutuesit e tjerë të cilave mund tu përgjigjen ose ti adresojnë.


Grafiku 8



Fuqia e argumentit më të mirë


Sërish, njëlloj si edhe në të gjitha periudhat e deritanishme të monitorimit të cilësisë së debatit, te deputetët mbetet mos-ndryshimi konstant i qëndrimeve dhe të pozicioneve për shkak të argumenteve më të mira të bashkë-diskutuesve. Në 30% të diskutimeve nuk kishte referencë për atë nëse deputetët ndërrojnë qëndrim. Në 45% të diskutimeve nuk kishte ndryshim të qëndrimeve, për shkak të të cilës deputetët kishin pozitë të njëjtë dhe e pranonin vlerën e argumenteve. Në 24% të diskutimeve deputetët mbetën në qëndrimin e vet dhe nuk e pranuan vlefshmërinë e argumenteve të folësve të tjerë. Në këtë periudhë, në vetëm 1% të diskutimit, pa marrë parasysh se deputetët kishin pozitë të ndryshme dhe nuk ndryshonin qëndrim, ata e pranuan vlefshmërinë e argumentit të tjetrit.

Grafiku 9



Edhe në këtë periudhë të monitorimit mund të konstatohet se deputetët nuk kanë vullnet për diskutim konstruktiv përmes mundësisë për ndërrimin e qëndrimeve. Deputetët e opozitës në 53% të diskutimeve të tyre nuk kanë ndryshim të pikëpamjeve, janë në të njëjtin pozicion dhe e njohin vlerën e argumenteve, ndërsa në 18% të diskutimeve të tyre nuk ka pasur ndryshim të qëndrimit dhe nuk janë njohur argumentet. Këtu duhet të kihet parasysh se 80% e diskutimit të përgjithshëm u zhvillua nga deputetët e opozitës. Ajo që është karakteristike në këtë periudhë është se 46% e diskutimit të pushtetit u karakterizua me atë që nuk kishte asnjë ndryshim të qëndrimit dhe nuk janë pranuar argumentet. Gjithashtu 39% e të diskutimeve të pushtetit karakterizohet me atë që nuk kanë referencë për vlerën e argumenteve të tjerëve, ndërsa të dy opsionet në vetëm 1% të diskutimit të tyre edhe pse nuk e ka ndryshuar qëndrimin dhe kanë një pozicion të ndryshëm, i kanë njohur vlerën e argumenteve të tjetrit.

Grafiku 10



IV. Respekt, ndërprerje dhe kufizime

Raport ndaj argumenteve dhe personalitetit të deputetëve të partisë tjetër


Shfaqja e formave të ndryshme të mosrespektimit ndaj folësve ose argumenteve të tyre mund ta ndryshojë atmosferën korrekte, e cila është parakusht themelor për zhvillimin e një debati racional dhe të argumentuar. Në të njëjtën kohë, mund ta ndryshojë rrjedhën e diskutimit dhe fokusin e deputetëve nga argumentet për t'u orientuar ndaj sulmeve dhe fyerjeve, me çka në mënyrë shtesë polarizohet atmosfera dhe pamundësohet debati esencial.

Deputetët më shpesh vendosën që ti bëjnë vështrim personalitetit të kolegëve të tyre se sa argumenteve të drejtuara.

Në 63% të diskutimeve ata nuk shprehët kurrfarë raporti të respektimit ose mos-respektimit ndaj **argumenteve** të folësve të tjerë, ndërsa në vetëm 25% të diskutimeve nuk shprehnin kurrfarë raporti ndaj **personalitetit** të folësve të tjerë. Në 36% të diskutimeve ata shfaqën respektim të pjesshëm ndaj argumenteve, ndërsa respektimi i pjesshëm ndaj personalitetit të deputetëve u shpreh në 70% të

diskutimeve. Kjo do të thotë se deputetët në pjesën më të madhe të diskutimeve nuk rezistuan që të vendosin shprehje tallëse ose shprehje të buta fyese dhe sulme ndaj personalitetit të kolegëve të tyre nga opsionet e kundërta politike. Me këtë rast, respektimi ndaj personalitetit është shprehur në vetëm 2% të rasteve, ndërsa ndaj argumenteve në vetëm 1% të rasteve. Në vetëm 1% të diskutimeve të monitoruara është vërejtur një mos-respektim i plotë ndaj personalitetit të kolegëve të tyre. Në këto raste folësit në diskutimet e tyre shprehën një mos-respektim të plotë për personalitetin e deputetëve të tjerë - duke përdorur fjalim abuziv.


Grafiku 11



Raport ndaj argumenteve dhe personalitetit të tjetrit sipas përkatësisë politike të deputetëve


Deputetët e opozitës në 68% të fjalimeve të tyre aspak nuk kishin referencë ndaj argumenteve të deputetëve nga pushteti, ndërsa në 31% të diskutimeve kanë pasur respekt të pjesshëm. Deputetët nga pushteti nuk kanë pasur referencë në 43% të diskutimeve të tyre dhe në 54% të diskutimeve të tyre kanë pasur respekt të pjesshëm ndaj argumenteve të opozitës. Deputetët nga pushteti gjithashtu në 1% të fjalimeve të tyre kanë përdorur fjalor fyese. Të dy opsionet në vetëm 1% të diskutimeve të tyre shfaqën respekt për argumentet e tjetrit.

Grafiku 12



Në lidhje me personalitetin e deputetëve të tjerë, në 73% të fjalimeve të opozitës shprehën respekt të pjesshëm, në 2% mos-respektim të pjesshëm, ndërsa në 1% mosrespektim. Në 23% të fjalimeve të tyre, deputetët nga opozita nuk kishin referencë ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë. Deputetët nga pushteti në 58% të diskutimeve të tyre kanë pasur respekt të pjesshëm, në 5% mos-respektim të pjesshëm dhe në 3% mos-respektim të plotë. Është e rëndësishme të theksohet se në vetëm 3% të fjalimeve të tyre, deputetët nga pushteti dhe në 1% deputetët nga opozita kanë shprehur respekt për personalitetin e kolegëve të tyre nga një parti tjetër politike.

Grafiku 13




Deputetët edhe në këtë, si edhe në periudhat e mëparshme, përdorën rrallë histori, anekdota ose shaka në diskutimet e tyre. Elemente të tilla janë vërejtur në gjithsej 4% të diskutimeve.

Në 6% të diskutimeve është vërejtur ndërprerje në fjalimin e folësit nga deputetët e tjerë. Këto janë ndërprerje në kohëzgjatje më së shumti deri në 10 sekonda të shkaktuara me hedhje fjalësh ndaj diskutuesve nga ana e deputetëve të cilët për momentin nuk e kanë marrë fjalën Pas ndërprerjeve, folësit i vazhduan diskutimet e tyre.

V. Demografia e folësve


Struktura demografike e folësve.

Grafiku 14



Për dallim nga periudhat e mëparshme të monitorimit, në këtë periudhë është rritur pjesëmarrja e grave në punën e Kuvendit. Ato në diskutimet e monitoruara morën pjesë me 40% të paraqitjeve.

Grafiku 15



VI. Metodologjia e hulumtimit

Cilësia e diskutimit në Kuvendin analizohet me përdorimin e “Indeksit për cilësi të debatit”. Indeksi është instrument i cili mundëson që çdo akt i veçantë i diskutimit në seancën e monitoruar të kodohet sipas disa karakteristikave kryesore:

- shkallë e argumentimit të fjalimit (sa argumente ka në çdo diskutim);
- shkallë e respektimit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;
- qëndrimi i hapur për pranimin e argumenteve të huaja dhe ndryshim të qëndrimeve të tyre për shkak të argumenteve më cilësore të prezantuara në debatin;
- nëse deputetët mund ti shfaqin qëndrimet e veta në mënyrë të papenguar.

Projekti Kuvendi nën thjerrëz

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz” është i financuar nga Agjencioni Zviceran për përkrahje dhe zhvillim. Në pjesën e aktiviteteve projekti përfshin monitorim 28 mujor të cilësisë së debatit kuvendor dhe monitorim i asaj se si mediet raportojnë për punën e Kuvendit. Monitorimi i debatit kuvendor dhe të raportimit mediatik filloi në shtator të vitit 2015 e do të zgjas deri në dhjetor të vitit 2017 dhe do të përfshijë analizë dhe raporte të njohurive të përfituara nga monitorimi në çdo tre muaj. Në periudhën e projektit do të përpilohen 9 raporte tremujore për cilësinë e debatit në parlamentin dhe 9 raporte tremujore për raportimin e medieve për punën e deputetëve. Në kuadër të projektit do të zbatohen dhe publikohen rezultatet e dy hulumtimeve të mendimit publik në terren për hulumtimin e perceptimit të qytetarëve për punën e Kuvendit.

Projekti paraqet vazhdim i projektit “Kuvendi nën thjerrëz – fuqizimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ”, i cili u financua nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut – EIDHR dhe u zbatua në periudhën nga shkurti i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2015.



Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin

maj - gusht 2017



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Институт за демократија
Социетас цивилис - Скопје